



REPUBLIKA E SHQIPERIS
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE
KORÇE

Nr. 218 Regj. Them
Data e Regj: 16.01.2015

Nr.218 Vendimi
Data:04.05.2015

V E N D I M

NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Korçe e perbere nga:

SOKOL IBI - Gjyqtar

Asistuar prej sekretares Marinela Rushi, pasi shqyrtoi ne seance gjyqesore publike, sot me date 04.05.2015, çeshtjen administrative me Nr.218 Regj.Them, qe i perket paleve ndergjyqese:

PADITES: "In Accessorize" sh.p.k, me seli ne Korçe, e perfaqesuar ne gjykim nga perfaqesuesi ligjor Andon Prifti (ne mungese).

I PADITUR: 1. Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim nga Mirela Veriga;
2. Drejtoria e Apelimit Tatimor, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim nga Mirela Veriga;
3. Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve (ne mungese).

OBJEKTI: 1. Shfuqizimin e aktit administrativ vendim Nr.31335/1 Prot. date 18.12.2014 i Drejtorise se Apelimit Tatimor;
2. Shfuqizimin e njoftim vleresimit Nr.5737/1 Prot, date 20.11.2014 per detyrimet tatimore (gjobe per mosleshim te kuponit tatimor) vendosur nga DRT-Korçe.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 32, 154 i K.Pr.Civile, nenet 58 e vijues te ligjit Nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne

R.SH", udhezimi Nr.24, date 02.09.2008, ligji Nr.10279, date 20.05.2010, nenet 116-131 e vijues te K.Pr.Administrative ligji Nr.49/2012.

Ne perfundim te gjykimit, gjykata pasi shqyrtoi provat ne teresi, ne konkluzionet perfundimtare pala paditese perfundimisht kerkoi pranimin e padise, pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe dhe Drejtoria e Apelimit Tatimor perfundimisht kerkoi rrezimin e padise, pala e paditur Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve ne mungese,

VEREN

Se paditesi "In Accessorize" sh.p.k eshte nje shoqeri tregetare me seli ne qytetin e Korçes e cila e ushtron aktivitetin e saj ne fushen e tregetimit me shumice dhe pakice te artikujve industriale, aksesore, kozmetike etj.

Pala paditese e ushtron aktivitetin e saj tregetar ne disa vende, midis te tjerave edhe ne Tirane prane qendres tregetare QTU.

Ne daten 17.10.2014 inspektoret e verifikimit ne teren prane Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane kane shkuar tek vendi i ushtrimit te aktivitetit tregetar nga pala paditese ne qytetin e Tiranës prane qendres tregetare QTU dhe kane mbajtur procesverbalin e titulluar "Akt Konstatimi" me numur serie 0435812, ku pershkruhet se nga ana e punonjesit te pales paditese eshte realizuar shitje produkti pa e shoqeruar shitjen me leshimin e kuponit tatimor megjithese pala paditese ka qene e pajisur me kase fiskale.

Ne daten 18.11.2014 inspektoret e pales se paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe duke u bazuar ne shkresen "Akt Konstatimi" te dates 17.10.2014 te mbajtur nga Inspektoret e Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane, kane hartuar procesvebalin e titulluar "Procesverbal Gjobe" ku kane konstatuar se pala paditese ka kryer kundravajtjen administrative te parashikuar nga neni 122 i ligjit Nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne R.SH" te mosleshimit te kuponit tatimor dhe per keto arsye kane vendosur qe pala paditese te denohet me gjobe ne masen 200.000 (dyqind mije) leke.

Nepermjet aktit administrativ "Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" Nr.5737/1 Prot, date 20.11.2014 pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe ka njoftuar palen paditese per detyrimin e saj per te paguar shumen prej 200.000 leke si gjobe per mosleshim te kuponit tatimor.

Sapo pala paditese vjen ne dijeni te ketij akti administrativ e kundershkon ate ne Drejtorine e Apelimit Tatimor.

Drejtoria e Apelimit Tatimor me vendimin e saj Nr.31335/1 Prot, date 18.12.2014 ka vendosur lenien ne fuqi te aktit administrativ "Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" Nr.5737/1 Prot, date 20.11.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe.

Ne te tilla rrethana pala paditese i eshte drejtuar me padine objekt gjykimi kesaj gjykate.

Pala paditese pretendon se nuk e ka kryer kundravajtjen administrative per te cilen eshte denuar me gjobe nga pala e paditur. Pala paditese pretendon se nuk ka kryer asnje shitje produkti pa leshuar kuponin tatimor.

Ne te tilla rrethana pala paditese pretendon se akti administrativ njoftim vleresimi per detyrime tatimore i leshuar nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe eshte nje akt administrativ i kundraligjshem. Gjithashtu pala paditese pretendon se per te njejtat arsye i kundraligjshem eshte edhe vendimi i Drejtorise se Apelimit Tatimor qe ka lene ne fuqi kete akt administrativ njoftim vleresimi per detyrime tatimore.

Pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe ka prapesuar duke pretenduar se pala paditese e ka kryer kundravajtjen administrative te mosleshimit te kuponit tatimor dhe ne te tilla rrethana gjoba ne masen 200.000 leke e vendosur ndaj pales paditese per kete shkak eshte e ligjshme.

Gjate gjykimit barren e proves e ka pala e paditur per te provuar faktet juridike qe kane te bejne me ligjshmerine e aktit administrativ "Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" Nr.5737/1 Prot, date 20.11.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe. Gjate gjykimit pala e paditur duhet te provonte faktin juridik te pretenduar prej saj se, pala paditese ka kryer shitje produkti pa leshuar kuponin tatimor, fakte te cilat mohoen nga pala paditese dhe qe kane qene shkak per vendosjen ndaj pales paditese te gjobes ne masen 200.000 leke per kryerjen e kundravajtes administrative te mosleshimit e kuponit tatimor.

Gjate gjykimit pala e paditur nuk paraqiti asnje prove per te provuar faktin juridik se paditesi ka kryer kundravajten administrative te mosleshimit te kuponit tatimor per shitje te kryer.

Ne te tilla rrethana gjykata çmon se pala paditese nuk e ka kryer kundravajten administrative te mosleshimit te kuponit tatimor per te cilen eshte denuar ne gjobe ne masen 200.000 leke nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe.

Per keto arsye si akti administrativ "Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" Nr.5737/1 Prot, date 20.11.2014 i Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe ashtu edhe vendimi i Drejtorise se Apelimit Tatimor qe ka lene ne fuqi kete akt administrativ njoftim vleresimi per detyrimet tatimore, jane akte administrative te kundraligjshme dhe duhen shfuqizuar nga gjykata.

Per keto arsye padia e paditesit eshte e bazuar ne prova dhe ne ligj dhe duhet pranuar nga gjykata, ndersa lidhur me palen e paditur Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve padia e paditesit duhet rrezuar nga gjykata sepse pala paditese nuk ka kundrejtuar ndonje kerkim ndaj ketij te padituri, por kerkimet i ka kundrejtuar ndaj dy te paditurve te tjere Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe si dhe Drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane, si organe te administrates publike qe kane nxjerre akte administrative qe kundershton me padi paditesi.

Ne baze te nenit 45 te ligjit Nr. 49, date 03.05.2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative", ndaj ketij vendimi nuk lejohet ankim, sepse objekt kerkimi eshte kundershtimi i akteve administrative qe permbajne detyrime ne te holla me vlere me te vogel se njezetefishi i pages minimale ne shkalle vendi. Paga minimale ne shkalle vendi me baze te V.K.M Nr.573, date 03.07.2013 eshte ne masen 22.000 leke, ndersa njezetefishi i saj eshte i barabarte me 440.000 leke.

PER KETO ARSYE

Gjykata ne baze te neneve 40, 41, 45 te ligjit Nr. 49, date 03.05.2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative"


VENDOSI

1. Pranimin pjeserisht te padise.
2. Shfuqizimin e njoftim vleresimit per detyrime tatimore Nr.5737/1 Prot, date 20.11.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe.
3. Shfuqizimn e aktit administrativ vendimit nr.31335/1 Prot, date 18.12.2014 te Drejtorise se Apelimit Tatimor.

4. Rrezimin e padise lidhur me palen e paditur Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve, si te pabazuar ne prova dhe ne ligj.
 5. Shpenzimet gjyqesore jane ne ngarkim te pales se paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korce ne masen 50% si dhe 50% ne ngarkim te pales se paditur Drejtoria e Apelimit Tatimor. Ky detyrim duhet te permbushet nga pala e paditur pas marrjes forme te prere te ketij vendimi duke derdhur ne llogarine bankare te kreditorit shumen e shpenzimeve gjyqesore dhe eshte nje detyrim i ekzekutueshem nga permbaruesi gjyqesor.
- Kunder ketij vendimi nuk lejohet ankim.
 - Nje kopje e ketij vendimi ti komunikohet paleve ne mungese.
 - U shpall sot me date 04.05.2015 ne Korçe.

SEKRETARE

MARINELA RUSHI



GJYQTAR

SOKOL IBI



Shpenzimet gjyqesore:

1. Takse pulle 3.000 leke;
- Totali 3.000 leke (te parapaguara nga paditesi).

Shenim: Vendimi ka marre forme te prere sot ne daten _____.

KANCELAR
ALEKSANDER DINO